

Tiranë, më 12.05.2020

Lënda: Shtojcë për modifikim në dokumentet e tenderit

Objekti i Prokurimit: “Përditësimi i moduleve, topologjisë dhe analizave për aplikacionet e rrjetit EMS”

Mbështetur në Nenin 42, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në Nenin 62, të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Njësia e Prokurimit, pas pezullimit për shkak të Njoftimit datë 31.03.2020, të Agjencisë së Prokurimit Publik për periudhën e pandemisë “Covid-19”, me iniciativën e saj, si dhe referuar sqarimit të Njoftimit Nr. 2371 Prot., datë 31.03.2020, të APP-së, bën ndryshimin e dokumenteve standarde të tenderit, për Procedurën e hapur - me mjete elektronike - Shërbime, me objekt “Përditësimi i moduleve, topologjisë dhe analizave për aplikacionet e rrjetit EMS”, me fond limit 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje / Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje shtyhet nga data 02.04.2020, ora 10:00, në datë **19.05.2020, ora 10:00.**